

# Lojra matematikore në shtëpi

Ushtrime-lojra  
për prindër e  
fëmijë

për fëmijë të moshës 4-7 vjeç

## «Luftë me letra bixhozi»\*

**Mjetet:** një pako letra bixhozi.  
Fillimisht i hiqni letrat me figura dhe përdorni  
vetëm letrat e tjera. Lojtarë: 2-5.

Mbani gjithmonë pranë jush letër dhe laps,  
sepse shënimet ndihmojnë të menduarit tonë!

### «Lufta»

Çdo lojtar/e tërheq nga një letër dhe ai/ajo që tërheq më të madhen mbledh letrat e të gjithëve. Në fund fiton ai/ajo që ka mbledhur më shumë letra.

### «Lufta e dyfishtë»

Çdo lojtar/e tërheq nga dy letra dhe mbledh të dy numrat me çdo lloj mënyre mundet. Ai/ajo që ka rezultatin më të madh fiton të gjitha letrat. Më vonë mund të ndryshoni rregullin e lojës dhe të thoni se fiton ai/ajo që ka numrin më të vogël. Në këtë rast lojtarët duhet të bëjnë zbritje.

### «Lufta e dyfishtë» me figurat

Pasi kemi luajtur lojën shumë herë me vajzën time, më kërkoi me insistim të vëmë në lojë edhe figurat. Pranova dhe vendosëm se çdo figurë do të numërohet për 10-të. Ky variant na dha shansin të bëjmë shumë mbledhje me këtë numër. Kështu, pas lojës së parë që luajtëm me figurat ajo mundte më pas të mbledhë automatikisht një numër njëshifror me 10-ën.



**Ide matematikore  
që ndërthuren**

- Rrjeshtimi i numrave dhe numërimi
- Përmbajtja e sasisë dhe e simboleve numerike (p.sh. 5 zemra simbolizojnë numrin 5)
- Krahasimi i sasive, (p.sh. 9 zemra janë më shumë se 8)
- Mbledhje dhe zbritje

## Çfarë nevojiten fëmijët që të zgjidhin lehtë problemet me mbledhje?



Fëmijët në këtë moshë, mund të bëjnë mbledhje:

- Me objekte reale si: tulla lodre, copa të vogla druri dhe sende të tjera të përdorimit të përditshëm.
- Me simbole të ndryshme që formojnë një sasi p.sh. pika, vija, etj. «Lufta e dyfishtë me letra bixhozi» si dhe lojra të tjera tavoline me zare, ndihmojnë fëmijët të fillojnë mbledhjen me simbole.
- Duhet të keni parasysh se nuk mund të bëjnë mbledhje me simbole numerike (d.m.th.  $3+8=11$ ), duke përjashtuar rastet e veçanta. Kjo ndodh sepse nuk munden akoma të kuptojnë çfarë do të thotë një «veprim aritmetik» (p.sh. veprimi  $3+8=11$  nuk ka kuptim për një fëmijë të kësaj moshe).

## Cilat mënyra përdorin fëmijët në kopshtin parashkollor dhe në klasën e I-rë fillore?

1. Fillimisht përdorin metodën e numërimit: numërojnë një e nga një sendet ose simbolet që përbëjnë dy sasi, p.sh. në lojën e mësipërme me letrat e bixhozit nëse kanë dy letra me numrat 3 dhe 5, do të numërojnë të gjithë sëbashku 1,2,3,4,5,6,7,8 **simbolet** e të dy letrave (p.sh. zemrat).
2. Më vonë fillojnë nga njëri mbledhës p.sh. 5 dhe vazhdojnë duke thënë tre numrat e ardhshëm 6, 7, 8. Kështu i shtojnë 5-s numrin 3.
3. Në një stad tjetër do të fillojnë të bëjnë mbledhje automatike me mend, diçka që vonon goxha.

## Tips!

Do të funksiononi si model për fëmijën tuaj nëse përdorni metodën e 2-të kur bëni mbledhje përpara tij/saj (si në lojë ashtu dhe në jetën e përditshme).

Dhe të mbani mend se sa më shumë shanse i jepni fëmijës të zbatojë **dy metodat** e para (me lojrat matematikore), aq më lehtë do të kalojë në metodën e 3-të. Por kurrë mos e presiononi të ndryshojë metodë! Do ta bëjë vetë kur ta kuptojë.

## Zbavitje të këndshme!

\* Versioni parësor i kësaj loje ndodhet në: Camii, C. K., De Clark, G. (1995). Fëmijët rizbulojnë aritmetikën. Shtëpia botuese Pataki.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsimit dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr  
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Maria Papandreu, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr  
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e

